




KRU "Gjakova" Sh.A. Gjakovë



Komuna Gjakovë

MARRËVESHJE

PËR BASHKËFINANCIM NË REALIZIMIN E PROJEKTIT "Ndërrimi i Gypave të Ujësjellësit në lagjen Skënderbeu nga AC në PE"

E lidhur në Gjakovë me datën 15.02.2022 në mes të palëve ;

Komuna e Gjakovës – të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës z. Ardian Gjini

K.R.U. "Gjakova" SH.A. - Gjakovë, të cilën e përfaqëson, U.D Kryeshef Ekzekutiv z. Visar Hasi, Ofruesi i Shërbimeve të ujit të pijes.

Neni 1. QËLLIMI I MARRËVESHJES

Nisur nga nevojat dhe interesi i përbashkët për ofrimin e shërbimeve sa më cilësore të furnizimit me ujë të pijes për banorët e rrugës Skënderbeu, është e domosdoshme të bëhet Ndërrimi i Gypave të Ujësjellësit nga AC në PE, me gjatësi 390 m².

Palët në marrëveshje pajtohen që realizimi i projektit të bëhet sipas kushteve të përcaktuara si në nenet të më poshtme.

Neni 2. OBLIGIMET E PALËVE NË MARRËVESHJE

1. Ekzekutimi i Projektit "Ndërrimi i Gypave të Ujësjellësit në rr. Skënderbeu nga AC në PE" dhe procedurat e prokurimit do të zhvillohen nga KRU "Gjakova" Sh.A. si dhe duke e angazhuar burimet e saj njerëzore dhe materialet që i posedon në depot e Kompanisë.
2. Kostoja totale e projektit të përshkruar në paragrafin një (1) të këtij neni, sipas paramasës dhe parallogarisë përfshinë vlerën 42.635.14 €.
3. Pas ndërrimit të gypit nga KRU "Gjakova" Sh.A., pala në marrëveshje, Komuna e Gjakovës pajtohet të bëjë rregullimin e trotuarit, vlera investive e së cilës do të zbritet nga kostoja totale sipas paramasës dhe parallogarisë.
4. Palët në marrëveshje pajtohen që të participojnë në koston e shpenzimeve si në paragrafin 2 të këtij neni.

5. Vlera totale e këtyre shpenzimeve përfshinë shumën 42.635.14 €, palët pajtohen që Komuna e Gjakovës të participoj me 49% të shumës totale, ndërsa KRU "Gjakova" Sh.A. nga buxheti i saj të participoj me 51 % të shumës totale.

Neni 3.

3.1. Palët nënshkruese në rast të mosmarrëveshjes do të zgjidhin me mirëkuptim dhe në frymën e marrëdhënieve të mira.

3.2. Kjo Marrëveshje konsiderohet e lidhur ditën e nënshkrimit të saj nga palët kontraktuese.

3.3 Kësaj Marrëveshje i bashkëngjitet edhe paramasa dhe parallogaria e investimeve të bëra në ndërrimin e gypit.

Ardian Gjini

Kryetari i Komunës së Gjakovës



Visar Hasi

U.D. Kryeshefi Ekzekutiv
KRU "GJAKOVA"SH.A

